

Nr. 712/B. Prot  
Date 25.02.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

- Sek. Këshillit Bashkiak  
- Dytore Ju Woklee  
- Dytore Ekonomike  
- Dytore Taksave

Nr. 135 / prot.  
2

Durrës, më 24.02.2025

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK**

**SHIJAK** ✓

**KRYETARIT TË BASHKISË**

**SHIJAK**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Shijak Nr.03 datë 07.02.2025, "Për miratimin e raportit të vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Shijak për vitet 2026-2028".

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", i ndryshuar e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**EMILJAN JANI**





Nr. 712/3 Pot

Data 12.02.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHIJAK  
DREJTORIA E TAKSAVE TARIFAVE DHE KADASTRES FISKALE

VENDIM  
Nr 3 date 07.02.2025

**Per miratimin e raportit te vlersimeve dhe parashikimeve afatmesme te te ardhurave te Bashkise Shijak per vitet 2026-2028**

Ne mbeshtetje te neneve 8,9,34,37,54 shkronja "F", 55 pika 3 te ligjit nr 139/2015 : "Per vetqeverisjen vendore", kreu III, neni 34, pika 1-3 te ligjit nr 68/2017 "Per financat e vetqeverisjes vendore" ligjin nr 9936 date 26.6.2008 "Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise", te ndryshuar, ligjin 9632 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise", te ndryshuar, ligjin nr 10296, date 8.7.2010, "Per menaxhimin financiar dhe kontrollin" te ndryshuar, Udhezimin nr 8 date 29.3.2012 te Ministrise se Financave "Per procedurat standarte te pergatitjes se programit buxhetor afatmesem,

**KESHILLI BASHKIAK**

**VENDOSI**

**Miratimin e Raportit te vlersimeve dhe parashikimeve afatmesme te te ardhurave te Bashkise Shijak per vitet 2026-2028 sipas dokumentit bashkelidhur.**

**A. Raporti I vlersimeve dhe parashikimeve afatmesme te te ardhurave te veta**

Te ardhurat e veta perfshijne te gjitha burimet e te ardhurave, me perjashtim te transfertes nga burimet qendrore. Keto burime te ardhurash bashkia I perdor per financimin e funksioneve te percaktuara nga Ligji nr 139/2015 "Per vetqeverisjen vendore"

Planifikimii te ardhurave nga taksat/tarifat eshte mbeshtetur ne paketen fiskale te bashkise Shijak e cila percakton llojet e taksave, bazen e taksueshme, kategorizimet dhe nenkategorizimet, kestet e pagimit, Kohen e kryerjes se tyre, efektet e lehtesive, strukturat pergjegjese per vjeljen e detyrimeve dhe agjentet tatimore.

Paketa fiskale percakton rregullat per menyren e ushtrimit te drejtave dhe te detyrave nga organet e qeverisjes vendore ,per vendosjen e taksave vendore ,mbledhjen dhe administrimin e tyre.Ne menyre te hollësishme,pervec strukturimit,detajon cdo lloj takse te administruar nga organet vendore te administrimit,percakton qarte dhe administrimin e saj duke filluar me menyren e llogaritjes ,personat pergjegjes te pagimit te takses dhe ato te mbledhjes se saj.

Paketa fiskale e Bashkise Shijak per kete kategori e hartuar dhe e ndryshuar edhe me perfshirjen e perfaqesve te komunitetit te biznesit e me konkretisht biznesit te madh dhe te vogel banoreve te njesive administrative,perfaqesve te komunitetit sipas interest,keshilltaret etj.,pasqyron disa politika te rendesishme per uljen e disa niveleve ligjore/kufi,etj,sipas kompetencave ligjore,si me poshte:

#### Politikat incentivuese ne taksa:

- Takse 0 (zero) ndertese per qellime banimi per invalidet
- Zbritje -10%e nivelit te takses per kategorine popullsia
- Nivelin minimal ligjor per taksen e ndikimit ne infrastructure
- Politikat incentivuese dhe uljet nen nivelet e kosto se sherbimit te llogaritur
- Tarife zero per ndricimin familet dhe pensionistet e vetmuar ,gra kryefamiljare per familjet me ndihme ekonomike ,familjet me persona invalide
- Tarife zero per pastrimin per familet dhe pensionistet e vetmuar ,gra kryefamiljare
- Tarifa te uleta pastrimi per familjet me ndihme ekonomike ,familjet me persona invalide


Procesi I planifikimit te te ardhurave te veta u realizua ne bashkepunim me administraten e bashkise ,me njesite administrative ,me institucionet e agjentet tatimore ,etj.Vazhdimi I ketij procesi bashkepunues do te mundesoje sigurimin e te ardhurave ,me efekt permirsimin e metejshem te sherbimeve qe ofron bashkia ndaj qytetareve te saj,duke raelizuar objektivet madhore ne funksion te zhvillimit te qendrueshem ne te gjithë teritorin ebashkise.

Te ardhurat nga burimet e veta vendore perfshijne te ardhurat nga taksat,te ardhurat nga tarifat dhe te ardhurat nga burimet e tjera.

Tabela 1

	Plan 2026	Plan 2027	Plan 2028
Te ardhurat e veta	357,050	373,839	384,669
Te ardhura nga Taksat Vendore	219,626	229,516	236,899
Te ardhura nga tarifat Vendore	69,776	73,265	76,467
Te ardhura te Tjera	4,648	4,880	5,124
Detyrime te pambledhura	63,000	66,178	66,178

### Te ardhurat nga Burimet e veta Vendore



Te ardhurat nga taksat vendore zene 61.5 % te planit te pergjithshem te te ardhurave, Nga tarifat rreth 19.5 %, dhe te ardhura te tjera dhe detyrime te pambledhura zene rreth 19. % te planit te pergjithshem te te ardhurave.


Zerat e taksave dhe tarifave qe ndikojne ne pjesen me te madhe te planit te te ardhurave nga burimet e veta jane kryesisht nga taksat vendore Taksa e nderteses 16 % te tij, Taksa e tokes bujqesore 4.2 %, Taksa e ndikimit ne infrastructure per ndertimet e reja 20%, Taksa e mjeteve te perdorura 8.%, Tarifat nga aluizni ,kontrolli teritorit 3% tarifa e pastrimit 15.5%.ejt



Keto zera mbulojne rreth 67 % te planit te te ardhurave te bashkise Shijak.

**Tabela 2**

Nr	Emertimi i Ardhurave Tatimore	Fakti 2023	Plan 2024	Fakt 2024	Plan 2025	Plan 2026	Plan 2027	Plan 2028
I.	<b>Të ardhura nga taksa</b>	<b>173,131</b>	<b>196,274</b>	<b>124,954</b>	<b>219,111</b>	<b>219,626</b>	<b>229,515</b>	<b>236,899</b>
1	Taksa vendore mbi biznesin e vogël	159	0	0	0	0	0	0
2	Taksa mbi Ndertesat	47,072	57,330	45,300	57,130	57,845	60,737	63,774
	BIZNESI	37,529	42,123	45,229	42,123	41,078	43,971	46,170
	POPULLSIA	9,543	15,207	18,071	15,207	15,967	16,766	17,604
3	Taksa mbi token bujqesore	10,009	21,836	12,954	21,836	21,836	21,836	21,836
4	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga n...	57,485	75,000	16,000	72,010	72,010	75,611	76,391
5	Taksa mbi kalimin e drejtës së pron për	8,148	2,100	7,133	4,121	4,121	4,327	4,543
6	Taksa vjetore e mjeteve te perdorura	14,402	13,230	17,082	29,000	29,000	30,450	31,973
7	Taksa trualli	9,274	6,615	5,467	8,413	8,413	8,834	9,275
8	Taksa e tabelës+ reklame	4,061	5,250	4,382	5,250	5,250	5,513	5,788
9	Taksa e perkohshme e tregut	311	520	401	520	520	546	573
10	Taksa e rentes mnerare	336	313	191	331	331	348	365
11	Te ardhura aluzni/kontrolli territori	10,141	8,400	9,904	10,800	10,800	11,340	11,907
12	Tatim mbi te ardhurat personale	11,733	5680	6140	9500	9500	9,975	10,474
II.	<b>Të ardhurat angatarifat</b>	<b>29,384</b>	<b>63,924</b>	<b>38,102</b>	<b>69,776</b>	<b>69,776</b>	<b>73,265</b>	<b>76,467</b>
1	Tarifat e pastrimit	23,043	55,175	31,935	55,175	55,175	57,934	60,830
	BIZNESI	10,721	22,055	16,537	22,055	22,055	23,158	24,316
	POPULLSIA	12,322	33,120	15,398	33,120	33,120	34,776	36,515
2	Tarife e Transportit	807	2,625	692	3,600	3,600	3,780	3,800
3	Tarife ndricimi rrugor	1,104	2,625	1,458	2,643	2,643	2,775	2,914
	BIZNESI	543	1,256	636	1,256	1,256	1,319	1,385
	POPULLSIA	561	1,369	822	1,387	1,387	1,456	1,529
4	Tarife leje sekt pyjeve dhe bujqesia	626	1050	1276	1050	1050	1,103	1,158
5	Tarife parkimi	36	50	70	50	50	53	55
6	Tarife per sherbime te tjera administrativ	993	840	1152	858	858	901	946
7	Tarife per sherbime sociale MNZ	775	509	479	1600	1600	1,680	1,764
8	Tarifa per dhenie licence naft	2,000	1050	1040	4800	4800	5040	5,000
III.	<b>Të ardhura nga shitja e pronës dhe dhën...</b>	<b>3,042</b>	<b>4,596</b>	<b>6,168</b>	<b>4,648</b>	<b>4,648</b>	<b>4,880</b>	<b>5,124</b>
1	Shitje Ndërtese							
2	Gjoha	429	2007	2996	2007	2007	2,107	2,213
3	Shitje te pronave te ndryshem							-
4	Qera Troje							-
5	Qera nga Ndertesat							-
6	Kopeshte+ cerdhe	2,613	2,589	3,172	2,641	2,641	2,773	2,912
	<b>TOTALI TE ARDHURA</b>	<b>205,557</b>	<b>264,794</b>	<b>169,224</b>	<b>293,535</b>	<b>294,050</b>	<b>307,660</b>	<b>318,490</b>
	Detyrime te Pamledhura	12,024	18,000	42,363	63,000	63,000	66,178	66,178
	<b>TOTALI TE ARDHURA</b>	<b>217,581</b>	<b>282,794</b>	<b>211,587</b>	<b>356,535</b>	<b>357,050</b>	<b>373,838</b>	<b>384,668</b>

### Te ardhura nga Taksat






### Ngarkesa fiskale sipas Njesive Administrative

Tabela 3

VITI	TOTALI	NJ.AD. SHIJAK	NJ.AD. XHAFZOTAJ	NJ.AD. MAMINAS	NJ.AD. GJEPALAJ
2026	357,050	61,357	190,511	85,704	19,478
2027	373,838	64,741	202,162	87,411	19,524
2028	384,668	65,329	210,284	89,441	19,614

Sic Shihet dhe ne tabelen nr pesha kryesore e te ardhurave I ngarkohet Nj. Administrative Xhafzotaj rreth 53.3 % e planit total te te ardhurave ,Nj.A Maminas 24 %,Nja.A Shijak 17.3%, dhe Nj.A. Gjepale 5.4% .

#### Ngarkesa Fiskale sipas Njesive Administrative



#### B. Kapacitetet Fiskale te Taksapaguesve


Paguesit e nivelit te taksave dhe tarifave vendore jane bizneset, institucionet dhe familjet e te gjitha njesive administrative. Per percaktimin e numrit te tyre jane konsideruar te dhenat per tatim paguesit, si dhe perjashtimet apo lehtesite fiskale sipas paketes fiskale te miratuar nga keshilli bashkiak.

Ne total kapaciteti I tatim paguesve eshte parashikuar rreth 13.533 (familje, biznese dhe institucione). peshen me te madhe numerike e mbajne familaret rreth 91.5%

Me poshte paraqitet tabela permbledhese e kapacitetit te tatim paguesve sipas kategorive dhe njesive administrative.

Tabela 4

Nr.	Bashkia Shijak	Familje	Biznes I Vogel	Biznes I Madh	Institucionet
1	Nj. Ad. Shijak	3815	191	31	17
2	Nj. Ad. Xhafzotaj	5645	318	221	19
3	Nj. Ad. Maminas	2289	128	57	18
4	Nj. Ad. Gjepalaj	1784	35	4	20
Totali		13533	672	313	74



### B1 Taksa paguesit familjare

Ne total numri I familjeve qe parashikohet te perfshihen ne skemen e detyrimeve fiskale te Bashkise Shijak eshte 13.533 familje. Nr i familjeve ne Nj.A. Xhafzotaj 5645 familje ose 41.7% te numrit te pergjithshem te familjeve ne Bashkine Shijak.

Parashikimi i te ardhurave nga familjet eshte bere duke ju referuar rregjistrave te gjendjes civile.

Ne planin e te ardhurave jane parashikuar lehtesi fiskale per familjet me probleme sociale, si per familjet me ndihme ekonomike, familje me persona invalide, pensioniste te vetmuar, veterane, gra kryefamiljare etj.

Me poshte tabela permbledhese per familjet sipas kategorie/lehtesive fiskale dhe sipas NJ, Administrative.


### Kapaciteti I familjeve taksapaguese

**Tabela 5**

Nr.	Bashkia Shijak	Familje	Familje me taksa te plota	Familje me lehtesi Fiskale	Familje me taksa 0
1	Nj. Ad. Shijak	3815	3121	457	237
2	Nj. Ad. Xhafzotaj	5645	5348	55	242

3	Nj. Ad. Mamlnas	2289	2233	14	42
4	Nj. Ad. Gjepalaj	1784	1506	206	72
Totali		13533	12208	732	593

### Kapaciteti i Familjeve Tatimpaguese



## B.2 Taksapaguesit Biznese dhe institucione

Bazuar ne regjistrat aktual, ne total nr i bizneseve qe parashikohet te perfshihen ne skemen e detyrimeve fiskale te bashkise Shijak eshte 1059. Biznesi i vogel 672 ose 63.4 % e nr te pergjithshem te bizneseve. Nr i institucioneve eshte 74 ku prfshihen institucionet e ndryshme. shkolla. kopshte. qendra mjeksore zyra dhe institucione te tjera shteterore.


Me poshte paraqitet tabela permbledhese e sipas xhiros dhe njesive administrative.

**Tabela 6**

**Kapaciteti I Bizneseve dhe institucioneve tatimpaguese**

Nr.	Bashkia Shijak	Totali	Biznes I Vogel	Biznes I Madh	Institucionet
1	Nj. Ad. Shijak	239	191	31	17
2	Nj. Ad. Xhafzotaj	558	318	221	19
3	Nj. Ad. Maminas	203	128	57	18
4	Nj. Ad. Gjepalaj	59	35	4	20
<b>Totali</b>		<b>1059</b>	<b>672</b>	<b>313</b>	<b>74</b>


**Kapaciteti i Bizneseve Tatimpaguese**



Ne tabelen e meposhtme paraqiten bizneset e vogla ku vihet re se pjesen me te madhe te biznesit te vogel e zene bizneset me aktivitet tregti e sherbime dhe zene 85.4% ndaj totalit te biznesit te vogel.

Nr.	Bashkia Shijak	Totali Biznes I Vogel	Nj. Tregtimi Sherbimi	Nj. Prodhimi	Ambulant+Transport
1	Nj. Ad. Shijak	191	164	9	18
2	Nj. Ad. Xhafzotaj	318	273	20	25
3	Nj. Ad. Maminas	128	108	16	4
4	Nj. Ad. Gjepalaj	35	29	2	4
<b>Totali</b>		<b>672</b>	<b>574</b>	<b>47</b>	<b>51</b>

### Kapaciteti Biznesi i Vogel




Ne tabelen e meposhtme per bizneset e medha vihet re se peshen me te madhe e ze aktiviteti tregti e sherbime 44% ndaj totalit te biznesit te madh, dhe subjekti prodhuese 34.2 % ndaj Totalit te bizneseve.

**Tabela 8**

### Kapaciteti I biznesit te madh sipas llojit te aktivitetit

Nr.	Bashkia Shijak	Biznes I Madh	Sub. Tregt+Sherb+Mag	Sub. Tregt. Karburante	Sub. Prodhimi	Sub. Ndertimi	Ente shtetere OJF
1	Nj. Ad. Shijak	31	24	1	1	5	17
2	Nj. Ad. Xhafzotaj	221	83	30	95	13	19
3	Nj. Ad. Maminas	57	29	15	9	4	18
4	Nj. Ad. Gjepalaj	4	2	0	2	0	20
Totali		313	138	46	107	22	74

Kapaciteti i Biznesit te Madh



## B. Detajimi i te ardhurave nga Taksat sipas zerave ,pesha ne te ardhurat e bashkise

Te ardhurat nga burimet e veta vendore, perfshijne te ardhurat nga taksat vendore, te ardhurat nga taksat e ndara, nga tarifat vendore, donacione dhe te ardhura te tjera.

Sipas Ligjit nr 139/2015 "per vetqeverisjen vendore" neni 35/2, bashkite e ushtrojne te drejten e vendosjes se nivelit te taksës, menyren e llogaritjes se saj, si dhe mbledhjen dhe administrimin e tyre brenda kufijve e sipas kriterëve te percaktuara ne ligj.

Llogaritja e te ardhurave te kesaj kategorie mbeshitet ne:

1. Ligjin 9632 date 30.10.2006 "Per sistemin e taksave vendore" i ndryshuar
2. Ligjin nr 9920 date 26.05.2008 "Per procedurat Tatimore ne R.Sh." i ndryshuar
3. Vendimin e Keshillit Bashkiak Shijak nr 40 date 10.12.2014 "Per Paketën Fiskale 2025"

### **1. Te ardhurat nga taksat vendore**

Ligji nr 9632 date 30.10.2006 "Per sistemin e taksave vendore" i ndryshuar perben ligjin baze i cili percakton rregullat per ushtrimin e te drejtave dhe detyrave te njesive te qeverisjes vendore ne drejtim te taksve vendore, mbledhjes dhe administrimit te tyre.

Per vitet 2026-2028 parashikohet qe te ardhurat nga taksat te perbejne rreth 69 % te te ardhurave te veta te bashkise

Pjese e rendesishme ne kete kategori te taksave vendore jane te ardhurat nga taksa e ndertesës 16 % te tij, Taksa e tokes bujqesore 4.2 %, Taksa e ndikimit ne infrastructure per ndertimet e reja 20%, Taksa e mjeteve te perdorura 8.%, Tarifat nga aluizni ,kontrolli teritorit 3% tarifa e pastrimit 15.5%.ejt

### **Te ardhurat nga taksat vendore**

Grafiku :Pesha sipas zerave te te ardhurave nga taksat

### **Te ardhurat nga taksa mbi pasurine e palujtshme**

Keto te ardhura perfshijne :

- Taksa mbi ndertesat
- Taksa mbi token bujqesore
- Taksa mbi truallin

**Parashikimi per vitet 2026-2028 bazohet ne zgjerimin e bazes se tatim paguesve nepermjet:**

- Saktesimit dhe vlersimit te drejte te siperfaqeve nepermjet grupeve te punes te ngritura per kete qellim
- Mbeshtetja ne agjentet tatimore
- Ndarjes me keste te pagesave
- Shtrirjes se metejshme e bazes se tatimpaguesve ,fale politikave fiskale lehtesuese dhe incentivave te ndermara ,rivlersimit te gjendjes faktike ,permirsimit te sherbimit dhe marredhenies me tatimpaguesit,si dhe bashkepunimit te pritshem me institucione si ZRPP,Aluizni etj.

### Te ardhurat nga Taksa mbi ndertesën

Me ndryshimet ne ligjin nr 9632 date 30.10.2006 "Per sistemin e taksave vendore" ,me ligjin nr 106/2017 date 30.11.2017 ,botuar ne fletoren zyrtare nr 222 date 19.12.2017 ,ndryshon shkalla e taksës mbi ndertesat , e cila aplikohet si perqindje e baze se taksës si me poshte:

A) 0.05 % per ndertesën qe perdoret,shfrytezohet per banim

B) 0.2 % per ndertesën qe perdoret,shfrytezohet per veprimtari ekonomike

Taksa vendore mbi pasurine e palujtshme ndertese llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit.Pagesa e taksës behet cdo muaj apo per periudha me te gjata ,ne vartesi te kategorise se taksapaguesit ,sipas percaktimeve te Keshillit te Ministrave.

### Te ardhurat nga taksa mbi token bujqesore

Kjo takse administrohet nga Bashkia Shijak.baza e taksës eshte siperfaqja e tokës bujqesore ne ha ,ne pronesi ose ne perdorim te taksapaguesit.

Me poshte paraqitet tabela e te ardhurave nga taksa e tokës bujqesore sipas kategorive te tokës dhe njesive administrative

Tabela 9

Nr	Kategoritë dhe nënkategoritë	sip. total	Sip.Xhafzotaj	Sip Maminas	Sip Gjepalaj	Niveli i taksës	Te ardhura
	Kategoria I	0				5,600	-
	Kategoria II	1979	1659		320	4,900	9,697,100
	Kategoria III	959	599	360		4,200	4,027,800
	Kategoria IV	1297		361	936	3,600	4,669,200
	Kategoria V	1105		418	687	3,000	3,315,000
	Kategoria VI	51		51		2,500	127,500
	Kategoria VII - X	0				1,800	-
	Totali	5391					21,836,600

Parashikimi i te ardhurave bazohet mbi kapacitetin fiskal te njesive administrative, mbi parashikimin per zgjerimin e baze se tatimpaguesve nepermjet saktësimit te te dhenave per siperfaqet reale dhe kategorizimin e sakte dhe aktual te tokës bujqesore, si dhe duke ju referuar tendences ne rritje te kapacitetit te realizimit te te ardhurave nder vite.

### Te ardhura nga Taksa mbi truallin

Baza e takses mbi truallin është sipërfaqja e truallit në meter katror ,në pronësi apo në përdorim të taksapaguesit.Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumentave që e vertetojnë ato. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësive përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim, pranë bashkisë ku ndodhet trualli. Për çdo kategori minimale të truallit, këshilli bashkiak mund të miratojë nënkategorizime.


Për bizneset dhe familjarët kjo taksë administrohet nga Bashkia Shijak.

Planifikimi i të ardhurave është bërë duke u bazuar në sipërfaqet aktuale, dhe mbi parashikimin për zgjerimin e bazës së taksapaguesve nga grupet e punës nëpërmjet saktësisimit të sipërfaqeve.

**Tabela 10 Të ardhura nga Taksa mbi truallin**

Nr.	Kateg dhe nenkateg	Sip. Total	Sip. Shijak	Sip. Xhafzo	Sip. Mamina	Sip. Gjepa	Niveli i Takses	Te ardhura
1	Per qellime banimi	923,543	-	180,733	430,447	312,363	0.182	168,085
2	Per qellime biznesi	674,571	1,600	480,553	190,629	1,789	16	10,523,308
	<b>Totali</b>	<b>1,598,114</b>	<b>1,600</b>	<b>661,286</b>	<b>621,076</b>	<b>314,152</b>		<b>10,691,392</b>

**Te ardhura nga Taksa mbi Truallin**



Pjesa më e madhe e sipërfaqes së taksueshme, rreth 41.12% e totalit, është në Njësinë Administrative Maminas.

Referuar kategorive të truallit, pjesa më e madhe e të ardhurave të parashikuara nga kjo taksë vjen nga trojet për qëllime biznesi (rreth 97%).

Të ardhurat nga taksa e truallit parashikohen me tendence rritje prej 5 % në vit

### **Te ardhura nga taksa e ndikimit ne infrastructure**

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja administrohet nga Bashkia Shijak.

Bazuar në ligjin 9632, taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja përcaktohet në kufijtë 4-8% e çmimit të shitjes për ndërtime për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit, të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo përdorim publik. Bashkia Shijak aplikon taksën minimale të lejuar nga ligji, 4% e çmimit të shitjes.

Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut sipas përcaktimeve të udhëzimit të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave", që miratohet çdo vit.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtime të ndryshme nga ato të përmendura më lart është 3% të vlerës së investimit që kërkohet të kryhet

Plani i të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë bazohet mbi parashikimin e lejeve për ndërtime të reja dhe shlyerjen e detyrimeve për objektet në proces legalizimi .


Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet në proces legalizimi administrohet nga Bashkia Shijak. Vjelja e kësaj takse paraqet vështirësi për bashkinë Shijak, për arsye se subjektet dhe familjarët pasi kryejnë procedurat e legalizimit pranë ALUIZNI-it, arrijnë të kryejnë regjistrimin e pronës pa shlyer detyrimin përkatës. Realizimi i ardhurave nga kjo taksë lidhet dhe bazohet në zbatimin e masave shtrënguese, bllokimin e shërbimit të debitorëve nga bashkia Shijak

### **Tabela 11**

#### **Te ardhura nga taksa e ndikimit ne infrastructure**

Nr.	Taksa e ndikimit ne infrastrukture	2026	2027	2028
1	T. e ndert. te reja (pervec sekt turizmit, ind apo publik)	48795	49871	50021
2	T. e ndert. te reja ne sekt turizmit, ind apo publik)	8910	9400	10363
3	T. ndert. te reja qe jane ne proces legalizimi	14305	16340	16007
Totali		72010	75611	76391

Taksa e Ndikimit ne Infrastrukture



#### Të ardhura nga Taksa e Tabelës

Bazuar ne Ligjin Nr. 9632, dt.30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", taksa e tabelës aplikohet për tre lloje tabelash, të përcaktuara sipas qëllimit të përdorimit dhe mënyrës së vendosjes së tyre: **Tabela për qëllime identifikimi**, të cilat nëse janë të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës ose brenda territorit ku zhvillon aktivitet biznesi. Tabelat me sipërfaqe më të vogël se 2 m<sup>2</sup> nuk taksohen. **Tabela për qëllime reklamimi**, ku përfshihen tabelat që nuk janë brenda territorit të biznesit ose nuk janë të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës, dhe që mund të jenë të thjeshta ose elektronike.

**Tabela për qëllime ekspozimi**, ku përfshihen tabelat me karakter të përkohshëm, për ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj.


Tabela 12

**Te ardhura nga taksa e tabelës dhe reklames**

**000/LEKE**

Nr.		2026	2027	2028
1	Tabele identifikimi mbi 2 m <sup>2</sup>	2481	2595	2760
2	Tabele identifikimi jashte territorit	165	194	203
3	Tabele reklamimi e thjeshte	1547	1647	1723
4	Tabele reklamimi elektronike	987	1005	1021
5	Ekspozime, stenda, banderola.	70	72	81
<b>Totali</b>		<b>5250</b>	<b>5513</b>	<b>5788</b>

**Te ardhura nga Taksa e Tabele+Reklame**



**Të ardhurat nga Taksat e ndara**

Të ardhurat nga taksat e ndara bazohen në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 25, Njësitë e vetëqeverisjes vendore marrin një përqindje nga taksat ose tatimet kombëtare që realizohen në juridiksionin e tyre. Taksat kombëtare që ndahen me njësitë e vetëqeverisjes vendore janë:

a-97 % e të ardhurave nga taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme për individë, personat fizikë dhe juridikë;

b-25 % e të ardhurave nga taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura;

c-5 % e të ardhurave nga renta minerare, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për taksat kombëtare; ç

ç-2 % e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale.

Sipas ligjit, të ardhurat e arkëtuara nga taksat e ndara transferohen te njësitë e

vetëqeverisjes vendore deri në fund të muajit pasardhës.

Për vitet 2019-2021 të ardhurat e parashikuara për bashkinë Shijak nga taksat e ndara përbëjnë rreth 12% të të ardhurave nga burimet e veta vendore.

#### **Të ardhura nga Taksa e regjistrimit të mjeteve të përdorura**

Bazuar ne ligjin 9975 dt. 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare” të ndryshuar përcaktohet administrimi i taksës kombëtare të regjistrimit të mjeteve të përdorura, ku pas arkëtimit nga institucione shtetërore ne rolin e agjentëve tatimorë, një pjesë e këtyre te ardhurave transferohen në buxhetin e njërive të qeverisjes vendore sipas përkatësisë nga burojnë.


Referuar pikës 3, të Nenit 4 të Ligjit 9975, Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor në rolin e agjentit tatimor, arkëton detyrimin nga pronari i mjetit për vlerën e taksës për automjetin, para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit. Bazuar në numrin e mjeteve të regjistruara, 18% e të ardhurave nga kjo taksë kalon për llogari të Bashkinë Shijak.

Planifikimi bëhet nga agjenti tatimor referuar numrit të automjeteve si dhe bazuar në eksperiencën e viteve të kaluara rereferuar të dhënave për nivelet e arkëtimeve.

**Tabela 13 Te ardhura nga Taksa e Rregjistrimit te mjeteve te perdorura**

	<b>Bashkia Shijak</b>	<b>Viti 2026</b>	<b>Viti 2027</b>	<b>Viti 2028</b>
	<b>Te ardhura</b>	<b>29.000</b>	<b>30.450</b>	<b>31.973</b>

**Te ardhura nga Taksa e Regjistrimit te Mjeteve te Perdorura**



#### **Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme**

Kjo taksë administrohet nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Taksa me nivelet sipas Ligjit Nr.9632 paguhet para kryerjes së regjistrimit, nga personi që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, dhe vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë


nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të cilat, në rolin e agentit tatimor përfitojnë 3% të shumës së arkëtuar, ndërsa diferencën e derdhin për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë Shijak, jo më vonë se data 30 e muajitpasardhës.

Planifikimi bëhet nga agjenti tatimor si dhe bazuar në eksperiencën e viteve të kaluara rereferuar numrit të procedurave të tjetërsimit të pronës të kryera nga vetë ato.

**Tabela 14 Të ardhura nga Taksa e kalimit të të drejtës së pronësisë**

Bashkia Shijak	Viti 2026	Viti 2027	Viti 2028
Te ardhura	4121	4327	4543


**Te ardhura nga Taksa mbi kalimin e të drejtës së Pronësisë**



**Tabela 15 . Te ardhura nga taksa e rentes minerare**

Bashkia Shijak	Viti 2026	Viti 2027	Viti 2028
Te ardhura	331	348	365

Te ardhura nga Taksa e Rentes Minerare



**Të ardhura nga tatimi mbi të ardhurat personale**


Bazuar në Ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Neni 25, Pika 2, të ardhurat e ardhura nga Drejtoria Rajonale Tatimore për tatimin mbi të ardhurat personale do të ndahet me njësitë e vetëqeverisjes vendore, dhe 2% e të ardhurave nga kjo taksë kombëtare i kalon përkatësisht Bashkisë Shijak në llogarinë e depës së thesarit

Planifikimi i të ardhurave i referohet realizimit të të ardhurave ndër vite nga agjenti tatimor

**Tabela 16**

Bashkia Shijak	Viti 2026	Viti 2027	Viti 2028
Te ardhura	9.500	9.975	10.474

Te ardhura nga TAP



**C. Te ardhurat nga Tarifat Vendore**

Referuar ligjit 139/2015" Për vetëqeverisjen vendore", neni 35/5, bashkitë krijojnë të ardhura nga tarifatat vendore për: shërbimet publike që ato ofrojnë; të drejtën e përdorimit të pronave publike vendore; dhënien e licencave, të lejeve, autorizimeve dhe për lëshimin e dokumenteve të tjera, për të cilat ato kanë autoritet të plotë, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe me ligj. Gjithashtu bashkitë mund të krijojnë të ardhura nga veprimtaritë e tyre kulturore, sportive, dhe të tjera, të përcaktuara me ligj.

Bashkitë vendosin vetë për nivelin, mënyrën e mbledhjes dhe të administrimit të tarifave vendore, në përputhje me politikat dhe parimet e përgjithshme kombëtare të përcaktuara në ligjet nëfuqi.

Për vitin 2025-2027 të ardhurat e parashikuara nga tarifatat përbëjnë rreth 23 % të të ardhurave të veta.

Peshën më të madhe në kategorinë e të ardhurave nga tarifatat vendore e zënë të ardhurat nga tarifatat për ofrimin e shërbimeve publike si pastrimi e largimi i mbetjeve me 84.6%, ndriçimi publik me 4.%, tarifatat transportit 4.0%.

Kriteri bazë për vendosjen e një tarife për shërbimin publik është kostoja e tij, e cila shpërndahet dhe paguhet nga familjet dhe bizneset si kontribues dhe përfitues të këtij shërbimi. Për të incentivuar dhe nxitur zhvillimin e disa kategorive të bizneseve, si dhe duke ju referuar nivelit ekonomik-social sipas zonave, ngarkesa e tarifimit është shpërndarë gjithashtu duke u bazuar edhe në:

vendndodhjen (zonë urbane apo zonës rurale),

llojin e aktivitetit (tregti, shërbim, prodhim, profesion i lirë, fermer, transport, ndërtim, karburant, institucion, ofj, etj)

dhe në statusin e subjektit (familjar, biznes i madh, biznes i vogël, institucion shtetëror, ambulant etj).


Parashikimi në rritje i të ardhurave nga biznesi bazohet në rritjen e njësisve takapaguese e në evidentimin e kapaciteteve të reja, si dhe në shtrirjen e mëtejshme të bazës takapaguese falë politikave fiskale lehtësuese, përmirësimit të shërbimit dhe marrëdhënies me takapaguesin, fokusimit në zona me kapacitete të pashfrytëzuara, si dhe sensibilizimin dhe trajtimin e biznesit si partner në dhënien e shërbimeve për komunitetin.

**Te ardhurat nga tarifatat e shërbimeve publike për pastrimin e largimin e mbetjeve, gjelbërimin, ndriçimin publik.**

Tarifatat familjare për pastrim, ndriçim, dhe gjelbërimin do të shlyhen nga takapaguesit pane sektorit të Taksava Vendore në Bashkinë Shijak për Nj.Ad.Shijak dhe në Njesite Administrative Xhafzotaj ,Maminas ,Gjepale për banoret e këtyre njesive.

**Tabela 17**

Nr.		2026	2027	2028
1	<b>Popullsia</b>	<b>34,507</b>	<b>36,232</b>	<b>38,044</b>
	Nj. Ad. Shijak	10,473	10,997	11,546
	Nj. Ad. Xhafzotaj	16,505	17,330	18,197
	Nj. Ad. Maminas	7,425	7,796	8,186
	Nj. Ad. Gjepalaj	104	109	115
2	<b>Biznese</b>	<b>23,311</b>	<b>24,477</b>	<b>25,701</b>
	Nj. Ad. Shijak	3,095	3,250	3,412
	Nj. Ad. Xhafzotaj	15,603	16,383	17,203
	Nj. Ad. Maminas	3,924	4,120	4,326
	Nj. Ad. Gjepalaj	689	723	760



**D. Të ardhura të tjera të bashkisë**

*Të ardhura nga shërbimet administrative*

Nga tarifa për shërbimet administrative që bashkia ofron si ato të drejtorisë të zhvillimit të territorit për aplikimet për leje, kontrole dhe verifikime, për aplikimet për AMTP-të etj si efekt i implementimit të disa tarifave të reja në paketën fiskale, planifikohet rritje prej 5% të ardhura në vit, të cilat parashikohet të mbulojnë tarifën për kostot administrative për shërbimin që i ofrohen subjekteve.

#### ***Të ardhura nga Tarifat e liçensimit të veprimtarive të transportit***

Plani i të ardhurave të parashikuara me rritje 5% në vit bazohet tek trendi i aplikimeve të tarifave të miratuara nga Ministria e Financave për subjektet që pajisen me liçensën dhe çertifikatën përkatëse për transport udhëtarësh ose mallrash, për vete ose për të tretë.

#### ***Te ardhura nga Tarifa për dhënie liçensë për tregtimin të naftës bruto e n/produkteve***

Bazuar në VKM Nr. 970, dt 02.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënie të liçensave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", ky zë parashikon rritje prej 1% të ardhura viti nga subjekte me aktivitet tregtim karburanti, që pajisen me liçensën përkatëse.

#### **Të ardhura nga Tarifat e sektorit të pyjeve dhe kullotave**

Të ardhurat e parashikuara me rritje 5% në vitin bazohen në trendin e aplikimeve të tarifave të shërbimeve administrative që kryen sektori i pyjeve dhe kullotave.

#### **Të ardhura nga Tarifat e shërbimeve të mbrojtjes nga zjarri**

Të ardhurat e parashikuara me rritje 5% bazohen në nivelin e tarifave të shërbimeve që kryen struktura të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit ndaj shtetasve dhe personave, juridik e fizik, vendas e të huaj, si dhe në realizimin e të ardhurave vitet e kaluara nga kjo strukturë.

#### **Të ardhura nga Tarifa për zënie të hapësirave publike**

Baza e taksës për zënie të hapësirave publike është sipërfaqja në m<sup>2</sup>, e cila vihet në shfrytëzim nga individë dhe subjekte për qëllime biznesi. Taksa llogaritet si detyrim mujor i taksapaguesit.

Parashikimi i të ardhurave me 5% është bërë duke ju referuar kërkesës në rritje për shfrytëzimin e hapësirave publike brenda juridiksionit të Bashkisë.

#### **Te ardhura të tjera**

Referuar ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 36, të ardhura nga burime të tjera janë: të ardhurat nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të bashkisë; të ardhurat nga investimet mbi kapitalet; të ardhurat nga titujt dhe të drejtat e tjera të blera nga bashkia; të ardhurat nga fitimi i ndërmarrjeve publike në pronësi; të ardhurat nga partneritetet privat-publik.

Bashkitë krijojnë të ardhura nga veprimtaritë e tyre ekonomike, qiratë dhe shitja e pronave, interesat, gjobat, kamatvonesat etj.

Të ardhurat nga burime të tjera përbëjnë në total vetëm 2% të të ardhurave nga burimet e veta vendore. Pjesë e rëndësishme në këtë kategori zënë të ardhurat nga kamatvonesat dhe gjobat, nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të bashkisë, si dhe shitja e mallrave dhe shërbimeve të ndryshme.

#### **Te ardhurat nga kundrvajtje administrative/gjobat**

Gjobat bazohen në ligjin Nr. 10 279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative":

Bazuar në Nenin 6.b, "Shkeljet që përbëjnë kundërvajtje administrative parashikohen me akte të këshillit bashkiak, për shkelje që nuk janë parashikuar si të tilla në ligje të veçanta, që kanë lidhje me fushat e veprimtarisë së tyre në njësitë territoriale përkatëse, ku, sipas ligjit, ushtrojnë funksionet e veta".

Bazuar në Nenin 10, "Masa e dënimit me gjobë përcaktohet nga ligji, i cili ka parashikuar kundërvajtjen administrative. Masa e dënimit me gjobë mund të jetë fikse apo e përcaktuar me kufij minimalë dhe maksimalë. Në rastet kur kundërvajtjet administrative parashikohen në aktet e miratuara nga këshilli bashkiak, masa e dënimit përcaktohet në këto akte.

Ky zë parashikon të ardhurat nga kamatvonesa për mosshlyerje detyrimi në afate ligjore nga bizneset, gjoba nga kontrole dhe inspektime tatimore, gjoba për kundrvajtje administrative që mund të vendosen nga Policia Bashkiake, nga Inspektoriati Ndërtimit Vendoretj.

Parashikimi i të ardhurave me me rritje rreth 9% në vit është bërë duke ju referuar trendit të të ardhurave ndër vite kryesisht nga kamatvonesat për shlyerje pas afatit të detyrimit tatimor të bizneseve, nga gjobat e Policisë Bashkiake dhe nga gjobat e vendosura nga Inspektoriati Vendor i Mbrojtjes së Territorit.

#### **Efekti ekonomik i lehtësive sociale përfamiljet**

**Tabela 18 Efekti ekonomik i lehtësive sociale për familjet**

<b>Efekti ekonomik i lehtësive, tarifativjetorefamiljare</b>	<b>në /000lekë</b>
	<b>Efekti financiar</b>
<b>Tarife Pastrimi</b>	7.451
<b>Tarife Ndriçimi</b>	1.024
<b>Taksa Ndertese</b>	6.584
<b>TOTAL</b>	

*Bashkia Shijak aplikon lehtësi tek taksa e ndertesës dhe tarifën vjetore të pastrimit, e ndriçimit për familjet perfitues të ndihmës ekonomike Invalidit, Paraplegjik, Tetraplegjik etj, dhe tarifa zero për 1.325 familje kur janë pensioniste të vetmuar, gra kryefamiljare etj. Efekti ekonomik i këtyre lehtësive llogaritet në total 15.059 mijë Lekë në vit.*

#### **E. Analiza e risqeve dhe masat për përballimin e tyre**

Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “ Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, përcakton parimet, rregullat, procedurat, strukturat administrative dhe metodat për funksionimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në njësitë e sektorit publik të Republikës së Shqipërisë, si dhe përgjegjësitë menaxheriale për planifikimin, zbatimin, kontrollin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin. Ligji përmban koncepte dhe përgjegjësi të reja për menaxhimin e riskut në institucionetpublike.

Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme që kanë efekt të dëmshëm mbi përmbushjen e objektivave të njësisë publike dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këto objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit tëngjarjes.

Identifikimi dhe menaxhimi i riskut mundëson strukturat drejtuese në çdo njësi në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi që kanë për realizimin e aktivitetit në to. Çdo drejtues është i vetëdijshëm se risku do të ekzistojë dhe nuk do të eliminohet kurrë tërësisht. E rëndësishme është që risku të menaxhohet në mënyrëefektive.

Strategjia e riskut përkufizohet si qasja e njësisë për menaxhimin e riskut e pasqyruar në politikat e nivelit të lartë të njësisë publike dhe më tej. Ajo përcakton mënyrën se si sillet njësi ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut.

Strategjia e riskut të njësisë duhet të përcaktojë në mënyrë të qartë strukturat përgjegjëse për menaxhimin, monitorimin dhe raportimin e risqeve. Për risqet që janë cilësuar më të lartat (më kritiket), duhet të hartohet një plan afat-gjatë veprimi.

Për realizimin e të ardhurave të veta vendore, njëkohësisht duke ruajtur tendencën për përmirësimin e politikave dhe strategjive incentivuese e zhvilluese të ekonomise lokale, është hartuar strategjia për menaxhimin e riskut duke kaluar në këto etapa:

- a) Identifikimi I objektivave
- b) Identifikimi i risqeve te jashtme dhe tëbrendshme.
- c) Analiza dhe vlerësimi i çdo risku (sipas probabilitetit dheimpaktit).
- d) Marrja e masave të metejshme, për pakësimin apo reduktimin eriskut.
- e) Paraqitja e të gjithë konkluzioneve tëarritura
- f) Krijimi i hartës së riskut, grupimi në bazë të impaktit dhe probabilitetit të ndodhjes së tyre, duke treguar në këtë mënyrë ato fusha të veprimtarisë së njësisë, ndaj të cilave duhet të regohet vëmendje e veçantë.
- g) Monitorimi dheraportimi.
- h) Hartimi i planit te veprimit për zbatimin e strategjisë.

## Regjistri i Riskut

Objektivat janë planifikimi buxhetor, llogaritja, analizimi dhe kontabilizimi i burimeve financiare të të ardhurave të veta, ndjekja e politikave dhe strategjive sensibilizuese, mbështetese dhe zhvilluese për krijimin e të ardhurave, zbutjes së informalitetit, rritjes së konkurrencës së ndershme, si dhe administrimi i marëdhëniet me taksapaguesit dhe shërbimi ndaj tij

1	2	3	4	5	6	7	8	9
Nr	Përshkrimi i riskut	Risku para kontrollit	Kontrollet ekzistuese	Risqet pas kontrollit të ekzistues	Nevoja për kontrolle të mëtejshme	Veprime për të adresuar boshlleqet	Zotëruesi i riskut	Ndryshimet në risk që nga detyra e fundit (përkeqësohet => përmirësohet <= i pandryshuar =)
1.	Mungesa e informacionit në terren	mesëm - ulët	Monitorime në terren nga inspektoret e zonës	ulët-ulët	po	Përgatitja e planit tëpunës përeveidentim	Spektori i taksave Ins terrenit	Përmirësuar
2	Mungesa e informacionit nga Z.R.Rr.Pasurisë Paluajtshme	mesëm - mesëm	Kërkesa shkresore për infomracion	Mesëm - mesëm	Po	Rritja e bashkepunimit me Z.R.Rr.Pasurive Paluajtshme	Zyra Rajonale eRegjistrimit të pasurive të Paluajtshme	Përmirësuar
3	Mungesa infomracionit nga QKR-ja	ulët-ulët	Kërkesa shkresore për infomracion	ulët-ulët	po	Bashkepunim me QKR-ne	QKR dhe Spektori i Regjistrimit	Përmirësuar
4	Dokumenacion i plotë arkivor	ulët-ulët	Pasurimi me dokumentacioni pronësie	ulët-ulët	Po	Pasurimi gjatë dheniës së shërbimit ndaj taksapaguesit	Spektori i Regjistrimit	Pandryshuar
1	Mungesa e infomracionit në Njësitë Administrative	mesëm - ulët	Monitorime ne terren nga Njësitë Administrative	ulët - ulët	po	Grupe të zgjeruara pëtevdientimine taksapaguesve	Njësitë Administrative dhe Spektori Familjar	Përmirësuar
2	Mungesa e informacionit nga Z.R.Rr.Pasurisë Paluajtshme	mesëm - mesëm	Kërkesa shkresore për infomracion	mesëm - mesëm	Po	Rritja e bashkepunimit me Z.R.Rr.Pasurive	Zyra Rajonale eRegjistrimit të pasurivetë paluajtshme	Përmirësuar

						Paluajtshme	dhe Sektori Familjar	
3	Mungesë informacioni për tokën bujqesore	mesëm - mesëm	Monitorime në terren nga Njësitë Administrative	mesëm - mesëm	po	Bashkëpunim me Drejtorinë e bujqësisë	Drejtoria e Bujqësisë dhe insp Familjar	Pandryshuar
4	Shërbim pranë taksapaguesit	ulët - ulët	Rritja e mundësisë së arkëtimit pranë taksapaguesit	ulët - ulët	jo	Zyrat postare prane nja	Inpektoret e taksave pop.sipas nj.administrative	Përmirësuar
5	Dokumenacion bazues për taksim	mesëm - mesëm	Pasurimi me dokumentacion i pronësie	mesëm - mesëm	Po	Pasurimi gjatë dhenies së shërbimit ndaj taksapaguesit	Sektori e tatim taksave	Përmirësuar
1	Ndjekja e masave shtrënguese	mesëm - mesëm	Njoftime në terren dhe me postë	mesëm - mesëm	po	Përgatitja e planveprimit	Sektori e tatim taksave	Përmirësuar
2	Rakordim i shpejtë i pagesave	ulët - ulët		ulët - ulët	jo	Plan veprimi për rakordimin e të ardhurave	Financa	Përmirësuar
3	Përmirësimi i marëdhënies taksapagues - taksambledhës	mesëm - ulët	Sensibilizim dhe njoftime të afateve propozim për taksa të përballueshme dhe incentive, ndarje e detyrimeve në këste, etj.	ulët - ulët	jo	Trajtimi dhe interpretimi i kërkesave nga subjektet	Sektori e tatim taksave	Përmirësuar
1	Realizimi i të ardhurave nga bizneset	ulët - ulët	Analiza mujore sipas zërave	ulët - ulët	po	Shqyrtimi i zërave sipas ecurisë	Sektori e tatim taksave	Përmirësuar
2	Realizimi i të ardhurave nga familjet	mesëm - ulët	Analiza sipas Njërive Administrative	ulët - ulët	po	Shqyrtimi i sipas ecurisë	Sektori familjar	Përmirësuar
3	Realizimi i të ardhurave nga agjentë tatimorë	ulët - mesëm	Analiza mujore	ulët - mesëm	po	Analizë për çdo agjent	Sektori i Finances	Përmirësuar
4	Realizimi i të ardhurave nga Drejtori të tjera dhe Institucione varësie	ulët - mesëm	Analiza mujore	mesëm	po	Analiza sipas Drejtorive	Drejtoritë e tjera dhe Institucionet e varësisë të bashkisë, sipas të ardhurave që planifikohet të realizojnë	Pandryshuar

Adresa: Lagja "Erzen" Shijak, Tel: +35557122152, website: [www.shllak.gov.al](http://www.shllak.gov.al), e-mail: [info@shllak.gov.al](mailto:info@shllak.gov.al)

1	Adaptimi dhe implementimi i programit të kompjuterizuar	mesëm <ulët< td=""> <td>Bashkëpunim me programuesit për adaptimin dhe implementimin e programit</td> <td>ulët<ulët< td=""> <td>po</td> <td>Evidentimi dhe shqyrtimi i nevojave për ndryshime dhe adaptime në program</td> <td>Programuesit e Sistemit dhe Sektori i regjistrimit dhe llogaritjes së detyrimit</td> <td>Përmirësuar</td> </ulët<></td></ulët<>	Bashkëpunim me programuesit për adaptimin dhe implementimin e programit	ulët <ulët< td=""> <td>po</td> <td>Evidentimi dhe shqyrtimi i nevojave për ndryshime dhe adaptime në program</td> <td>Programuesit e Sistemit dhe Sektori i regjistrimit dhe llogaritjes së detyrimit</td> <td>Përmirësuar</td> </ulët<>	po	Evidentimi dhe shqyrtimi i nevojave për ndryshime dhe adaptime në program	Programuesit e Sistemit dhe Sektori i regjistrimit dhe llogaritjes së detyrimit	Përmirësuar
---	---	---	---	--	----	---	---	-------------

**Kryetari i Keshillit Bashkiak**

**Sulejman Toig**



Adresa: Lagja "Erzen" Shijak, Tel: +35557122152, website: [www.shijak.gov.al](http://www.shijak.gov.al), e-mail: [info@shijak.gov.al](mailto:info@shijak.gov.al)